



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, DATË, ____/____/202__

PËR

MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË TOTALE 50'572'489 (PESËDHJETË MILIONË E PESËQIND E SHTATËDHJETË E DY MIJË E KATËRQIND E TETËDHJETË E NËNTË LEKË), PËR LIKUIDIMIN E PLOTË TË DISA FAMILJEVE DHE PËR LIKUIDIMIN ME KËST TË PJESËS TJETËR, TË DËMTUARA NGA PËRMBYTJET E SHKAKTUARA NGA RESHJET INTENSIVE TË SHIUT TË DATAVE 29.01.2025 – 30.01.2025

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 492/1 prot. datë 25.02.2025 me kodin e produktit: "Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme" - kodi i produktit 91707AB dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Sherbimeve Publike, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë totale 50'572'489 (pesëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025 – 30.01.2025, e ndarë si më poshtë:

- a) Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë 6'592'545 (gjashtë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dyzet e pesë) lekë për 89 familje që do të likujdohen plotësisht, për të cilat vlera e dëmit të konstatuar është më e ulët se shuma e kësti për familjet që do të trajtohen me ndihmë financiar e ndarë në këste, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur.
- b) Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë 43'979'944 (dyzet e tremilionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekë për 342 familje të cilat do të trajtohen me këste, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur.
2. Dhënia e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025 – 30.01.2025 do të përballohet nga:
- a) Fondi me vlerë 37'572'489 (tridhjetë e shtatë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë, e cila do të merret nga fondi i papërdorur, i alokuar nga Ministria e Financës më shkresën me nr. 492/1 prot, datë 25.02.2025 me kodin e produktit 91707AB, *"Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme"*.
- b) Diferenca prej 13'000'000 (trembëdhjetë milionë) lekë do të merret nga buxheti i Bashkisë Durrës, i dedikuar për programin "Emergjencat Civile", e cila vihet në dispozicion për përballimin e këtij procesi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Sherbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtor
Alneda Rroshi

DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtor
Valbona Qiriako

**DREJTORIA E SHERBIMEVE
PUBLIKE**

Drejtor
Ardian Iljazaj

DREJTORIA EKONOMIKE

Drejtor
Ina Ferra

KRYETAR
Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
DREJTORIA E BUXHETIT

RELACION

PËR

MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË TOTALE 50'572'489 (PESËDHJETË MILION E PESËQIND E SHTATËDHJETË E DY MIJË E KATËRQIND E TETËDHJETË E NËNTË LEKË), PËR LIKUIDIMIN E PLOTË TË DISA FAMILJEVE DHE PËR LIKUIDIMIN ME KËST TË PJESËS TJETËR, TË DËMTUARA NGA PËRMBYTJET E SHKAKTUARA NGA RESHJET INTENSIVE TË SHIUT TË DATAVE 29.01.2025 – 30.01.2025

1. Baza Ligjore

- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”.
- Vkm nr. 329 datë 16. 05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.
- Vkm-së 414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, dhe VKM-së nr. 290, datë 17.05.2023, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

2. Relatimi i çështjes

Të nderuar këshilltarë !

Në vijim të detyrimeve ligjore të Bashkisë Durrës për evidentimin dhe trajtimin e pasojave të fatkeqësive natyrore, paraqitet për shqyrtim ky material lidhur me përmbytjet e ndodhura në datën 30 janar 2025, si rezultat i reshjeve të dendura dhe jashtëzakonisht intensive të shiut, të cilat shkaktuan dëmtime në banesa dhe pasuri të shtetasve në zona të ndryshme të territorit të Bashkisë Durrës. Sipas shkresës zyrtare të Shërbimit Meteorologjik të Ushtrisë nr. 149/1 prot, datë 11.03.2025, nga

regjistrimet zyrtare për datën 30.01.2025 rezulton se kanë rënë 92.2 mm reshje, një vlerë tepër e lartë, e cila përfaqëson pothuajse 10% të sasisë vjetore të reshjeve. Ky intensitet i pazakontë ka krijuar kushtet për përmytje të menjëhershme në rrjetin urban, në zonat me problematikë kullimi dhe në territoret periferike ku kapacitetet e shkarkimit nuk kanë arritur të përballojnë fluksin e papritur të ujërave. Menjëherë pas raportimeve të para të qytetarëve dhe strukturave të Njësisë Administrative, Bashkia Durrës aktivizoi grupet e punës me urdhrin nr. 34, datë 30.01.2025, për evidentimin në terren të dëmeve dhe mbledhjen e informacionit fillestar.

Grupet e punës të ngritura posaçërisht për këtë qëllim, kryen mbledhjen e të dhënave, fotografimin, hartimin e akteve përkatëse dhe regjistrimin e çdo familjeje të prekur, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 329/2012 dhe udhëzimeve ndërinstucionale. Pas finalizimit të këtij procesi, u ngrit komisioni zyrtar i vlerësimit të dëmeve me, urdhrin nr. 50, datë 12.02.2025, ndryshuar me urdhrin nr. 58, datë 17.02.2025, i cili kishte për detyrë kryesore verifikimin teknik, matjen, preventivimin dhe përgatitjen e akteve përfundimtare mbi dëmet e shkaktuara nga përmytjet e datës 30.01.2025. Komisioni ka kryer vlerësimin përfundimtar duke u bazuar në standardet e parashikuara në kreun II dhe III të VKM nr. 329/2012, “ *Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*”, duke përgatitur preventivat dhe dokumentacionin teknik për secilin përfitues. Materiali i konsoliduar, së bashku me preventivat respektivë, është përcjellë nga grupet e vlerësimit me shkresë pranë strukturave përkatëse me nr. 2212/3 prot, datë 28.02.2025.

Në vijim të analizës së dokumentacionit të dorëzuar nga Njësitë Administrative dhe të preventivave të hartuara nga komisionet e vlerësimit, rezulton se vlera totale e dëmeve të konstatuara arrin në 121,430,638.9 lekë. Duke qenë se fondi i miratuar nga Bashkia Durrës për menaxhimin e emergjencave civile për vitin 2025 është në masën 13,000,000 lekë, ndërsa fondi i kushtëzuar i miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile për këtë qëllim është 37,572,489 lekë, vlera e përgjithshme e disponueshme për trajtimin financiar të këtij rasti përmytjeje është 50,572,489 lekë. Në kushtet kur shumat e dëmeve të konstatuara tejkalojnë ndjeshëm fondin në dispozicion, Bashkia Durrës, me shkresën nr. 2958/3 prot, datë 20.10.2025, ka kërkuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile orientim mbi metodologjinë më të përshtatshme të përdorimit të fondit në raport me numrin e lartë të familjeve të dëmtuara dhe diferencën e konsiderueshme financiare midis vlerës së dëmeve dhe fondeve të disponueshme. Përgjigjja e kthyer nga AKMC me shkresën nr. 1921 prot, datë 28.10.2025, ka ofruar sqarime të përgjithshme, por pa përcaktuar një metodë të posaçme zbatimi për situatat të kështilla ku kapacitetet buxhetore janë dukshëm më të ulëta se vlerësimi i dëmeve të konstatuara. Për këtë arsye, *vlerësohet se vendimmarrja mbi mënyrën e shpërndarjes së fondit, qoftë përmes likuidimit të plotë të një pjese të përfituesve, qoftë përmes një kësti proporcional për pjesën tjetër të mbetet Këshillit Bashkiak të Durrësit, si organi kompetent për miratimin e përdorimit të fondeve publike në kushtet e emergjencave civile.* Në mungesë të një vendimmarrjeje, fondi i dedikuar për këtë qëllim rrezikon të mbetet i paangazhuar brenda afatit buxhetor të përdorimit.

3. Sipas ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”

Bazuar në ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen Civile” **neni 41, pika 2** “Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile.”

pika 3 “Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë i planifikojnë ato për vitin pasardhës, deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara.”

pika 4 “Në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8 % të buxhetit të bashkisë, KMC-ja vendos që kompensimi të kryhet nga AKMC-ja”.

Ndërkoh në nenin 65 pika 1 thuhet se;

“Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.”,

po kështu edhe në pikën 2 thuhet se: “Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si më poshtë”:

- a) nga të ardhurat e veta vendore;
- b) nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet;
- c) si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

neni 30, pika “gj” ku thuhet se;

“Bashkitë kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre”.

4. Sipas VKM-në 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.”

Ky akt parashikon në mënyrë të qartë rastet e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, në të cilat shteti ndihmon financiarisht familjet e dëmtuara, kur si pasojë e këtyre fatkeqësive shkaktohen dëme në njerëz ose dëme materiale, si në kushtet e shpalljes së gjendjes së emergjencave civile, ashtu edhe gjatë funksionimit normal të strukturave të mbrojtjes civile. Për rastin konkret të përmytjeve të datës 30.01.2025, të gjitha praktikatat dhe dokumentacioni tekniko-ligjor janë hartuar nga Njësitë Administrative përkatëse, sipas kompetencave të deleguara dhe në zbatim të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

Vlerësimi teknik i dëmeve të shkaktuara në banesat e qytetarëve është kryer nga grupet e inxhinierëve të Bashkisë Durrës, të ngritur për këtë qëllim, në përputhje me përcaktimet e Kreut II dhe III të VKM nr. 329/2012, si edhe në mbështetje të Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, pika gj), ku përcaktohet detyrimi ligjor i njësive të vetëqeverisjes vendore për të kryer vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblimin e shtetasve për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre. Grupet e inxhinierëve të autorizuar kanë realizuar matjet, preventivimin dhe përgatitjen e akteve përfundimtare për secilin subjekt të dëmtuar, duke ndjekur metodologjinë e përcaktuar në VKM nr. 329/2012 dhe udhëzimet përkatëse teknike. Bashkia Durrës, në zbatim të procedurave ligjore, me shkresën nr. 3814 prot, datë 19.03.2025, i është drejtuar zyrtarisht Këshillit të Qarkut Durrës për të marrë qëndrimin mbi mundësinë financiare të këtij institucioni për mbështetjen e familjeve të dëmtuara nga përmbytjet. Këshilli i Qarkut, me shkresën nr. 152/1 prot, datë 26.03.2025 (administruar me nr. 3814/1 prot, datë 27.03.2025), ka bërë me dije se nuk ka mundësi financiare për të përballuar detyrimet e kompensimit. Në mungesë të mbështetjes financiare nga qarku, mbulimi i dëmeve kryhet nëpërmjet programit "Emergjencat Civile" të Bashkisë Durrës dhe fondit të kushtëzuar të akorduar nga AKMC, siç parashikohet në pikën "f" të VKM nr. 329/2012, ku përcaktohet se fondet për dhënien e ndihmës financiare akordohen nga buxheti i njësive të qeverisjes vendore dhe programi i emergjencave civile.

Në vijim të kësaj baze ligjore dhe dokumentacionit të plotë të hartuar, çështja i paraqitet për shqyrtim dhe miratim Këshillit Bashkiak të Durrësit, si organi kompetent për miratimin e përdorimit të fondeve publike për trajtimin financiar të dëmtimeve të shkaktuara nga përmbytjet e datës 30.01.2025. Në vijim të kësaj baze ligjore dhe dokumentacionit të hartuar, i lihet në vlerësimin dhe miratimin e Këshillit Bashkiak trajtimi financiar i rasteve të dëmtimeve të shkaktuara nga përmbytjet e datës 30.01.2025. Në zbatim të VKM nr. 329/2012, Bashkia Durrës, me shkresën nr. 3814 prot, datë 19.03.2025, i është drejtuar Këshillit të Qarkut Durrës për të marrë qëndrimin mbi mundësinë apo pamundësinë financiare të këtij institucioni për mbështetjen e familjeve të dëmtuara nga përmbytjet. Këshilli i Qarkut, me shkresën nr. 152/1 prot datë 26.03.2025 (administruar me nr. 3814/1 prot, datë 27.03.2025), ka bërë me dije se nuk ka mundësi financiare për të përballuar detyrimet e kompensimit.

Përfitimi financiar i shtetasëve të dëmtuar është si mëposhtë:

- Dëmet e shkaktuara në orendi, sende apo elektroshtëpiake do të kompensohen në masën 100 % të vlerës së llogaritur sipas preventivave të përgatitura nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës.*
- Ndërkoh dëmet e shkaktuara në materiale ndërtimore, do të kompensohen në masën 50 % të vlerës së preventivit, kjo e bazuar në kreun III, nenit 3, pika "ç" Masa e ndihmës financiare për dëmtime individuale ose në grupe të vogla të banesave jepet nga Ministria e Brendshme ose njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet fondit të miratuar në buxhetin e vitit në programin "Emergjencat civile". Ajo do të llogaritet në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në shkronjat "h" dhe "c" të kësaj pike dhe do të jetë 50% e vlerës së llogaritur"...*

- 5. Sipas VKM-së nr.414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", dhe VKM-**

së nr. 290, datë 17.05.2023, "Për një ndryshim në Vendimin nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".

Institucionet e qeverisjes vendore, për përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore në fushën e mbrojtjes civile, përfitojnë çdo vit nga buxheti i shtetit një fond të kushtëzuar me destinacion të qartë të përcaktuar. Referuar nenit 3 të VKM nr. 414/2021 (i ndryshuar me VKM nr. 290/2023) citohet se: *"Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile përdoret sipas prioritizimit, si më poshtë vijon: "*

"3.1. 60% – 100% e fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për:
a) akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, sipas kriterëve specifike të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 41."

Në funksion të sa më sipër, dhe duke marrë në konsideratë detyrimet ligjore që burojnë nga ky kuadër nënligjor, përdorimi i fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile nga Bashkia Durrës është një domosdoshmëri për të mbështetur financiarisht familjet e dëmtuara nga përmbytjet e datës 30.01.2025. Ky fond synon lehtësimin e pasojave të menjëhershme të fatkeqësisë dhe rikthimin sa më të shpejtë të kushteve normale të jetesës për qytetarët e prekur. Akordimi i kësaj ndihme financiare, në përputhje me nenin 3 të akteve nënligjore që rregullojnë përdorimin e fondit të kushtëzuar, përbën një mekanizëm të qartë dhe të vlefshëm institucional për rimëkëmbjen e banesave të dëmtuara dhe për sigurinë e mjedisit të banimit të familjeve të prekura nga përmbytjet. Në përputhje me sa është relatuar në paragrafët e mësipërm, si dhe duke u bazuar në dokumentacionin teknik dhe verifikues të përgatitur nga strukturat vendore dhe të miratuar nga institucionet kompetente qendrore, i propozohet Këshillit Bashkiak të miratojë listën emërore të familjeve të dëmtuara dhe vlerat financiare përkatëse, siç pasqyrohen në tabelën bashkëlidhur. Ky miratim do të mundësojë vijimin e procedurave financiare për likuidimin e ndihmës ndaj përfituesve, duke garantuar zbatim të drejtë, të unifikuar dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Ky fond do të përdoret nga Fondi i Kushtëzuar për Emergjencat Civile për vitin 2025, i alokuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 492/1 prot, datë 25.02.2025, si dhe i konfirmuar për përdorim nga Bashkia Durrës me shkresën nr. 2958/1 prot, datë 28.02.2025, sipas destinacionit të përcaktuar:

- *"Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme" – kodi i produktit 91707AB. Vlerë e mbetur 37'57',489 lekë e pa përdorur.*
- *Diferenca prej 13'000'000 lekë nga buxheti i Bashkisë Durrës e dedikuar për programin "Emergjencat Civile", e cila vihet në dispozicion për përballimin e këtij procesi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.*
- *Vlera totale 50'572'489 (pesëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.*

Në përputhje me fondin e disponueshëm dhe metodologjinë e shpërndarjes së miratuar, bashkëlidhur gjeni Aneksin nr. 1 me listën e 89 familjeve që do të likujdohen plotësisht, për të cilat vlera e dëmit të

konstatuar është më e ulët se shuma e kesti për familjet që do të trajtohen me ndihmë financiar e ndarë në këste dhe Aneksi nr. 2 me listën 342 familjeve të cilat do të trajtohen me këste proporcional, të llogaritur mbi bazën e fondit total të vënë në dispozicion për këtë proces. Kjo skemë garanton shpërndarje të drejtë, transparente dhe në përputhje me kuadrin ligjor, duke balancuar numrin e lartë të rasteve të dëmtuara me kufizimet buxhetore të momentit.

Përsa më sipër kërkojmë nga Këshilli Bashkiak:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë totale 50'572'489 (pesëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025 – 30.01.2025, e ndarë si më poshtë:
 - a) Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë 6'592'545 (gjashtëmilion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dyzetë e pesë) lekë për 89 familje që do të likujdohen plotësisht, për të cilat vlera e dëmit të konstatuar është më e ulët se shuma e kesti për familjet që do të trajtohen me ndihmë financiar e ndarë në këste, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur.
 - b) Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë 43'979'944 (dyzetë e tremilion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e dyzetë e katër) lekë për 342 familje të cilat do të trajtohen me këste, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur.
2. Dhënia e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025 – 30.01.2025 do të përballohet nga:
 - a) Fondi me vlerë 37'572'489 lekë, e cila do të merret nga fondi i papërdorur, i alokuar nga Ministria e Financës më shkresën me nr. 492/1 prot, datë 25.02.2025 me kodin e produktit 91707AB, "*Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme*".
 - b) Diferenca prej 13'000'000 lekë do të merret nga buxheti i Bashkisë Durrës, i dedikuar për programin "Emergjencat Civile", e cila vihet në dispozicion për përballimin e këtij procesi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtor

Ardjan Iljazaj



DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtor

Valbona Qiriako



Relacioni, përmban dokumentacionin e mëposhtëm sipas praktikave respektive.

- Urdhri nr. 34, datë 30.01.2025 *"Për ngritjen e Komisioneve të Konstatimit të Dëmeve të shkaktuara nga përmytja dhe rënia e reshjeve të shirave, në datën 29.01.2025, në territorin e Bashkisë Durrës"*
- Urdhër nr. 50, datë 12.02.2025, *"Për ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Dëmeve të shkaktuara nga përmytjet e reshjeve të shirave të datës 30.01.2025, në territorin e Bashkisë Durrës"*, i ndryshuar me urdhrin nr. 58, datë 17.02.2025,
- Shkresa me nr. 3814 prot, datë 19.03.2025 *"Kërkesë për shprehje të mundësisë financiare, për efekt procedural në zbatim të VKM-së 329, datë 16.05.2012"*.
- Shkresa nr.152/1 prot, datë 26.03.2025 *"Përcjellje dokumentacioni dhe pamundësi financiare"*
- Shkresa nr. 2212/3 prot, datë 28.02.2025 *"Përcjellje e listës emërore të familjeve të dëmtuara nga përmytjet e datës 30.01.2025 të kualifikuar së bashku me vlerësimin financiar të dëmeve të shkaktuara", nga Komisioni i Vlerësimit të Dëmeve.*
- Shkresa nr.3292 prot, datë 06.03.2025 *"Kërkesë për info mbi sasitë e reshjeve të shirave vjetore për periudhën 2015-2025"*
- Shkresa nr.149/1 prot, datë 11.03.2025 *"Kthim përgjigje shkresës nr.3292 prot, datë 06.03.2025"* nga Ministria e Mbrojtjes, për shirat.
- Shkresa nr.492/1 prot, datë 25.02.2025 *"Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"*
- Shkresa nr.2958/1 prot, datë 28.02.2025 *"Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"*.
- Shkresa nr.2958/2 prot, datë 19.03.2025 *"Kërkesë për plotësimin e fondit të kushtëzuar në masën 4 %, për mbrojtjen civile dhe adresimin e problemit në AKMC."*
- Shkresa nr.492/57 prot, datë 25.04.2025 *"Kthim përgjigje", mbi fondin e kushtëzuar"*
- Shkresa nr.1117/1 prot, datë 09.06.2025 *"Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"*
- Shkresa nr.448 prot, datë 03.07.2025 *"Për përdorimin e fondit të kushtëzuar në fushën e mbrojtjes civile, për vitin 2025"*.
- Shkresa nr. 2958/3 prot, datë 20.10.2025 *"Kërkesë për shprehje mendimi lidhur me shpërndarjen e fondit të kushtëzuar për vitin 2025"*
- Shkresa nr.13237/1 prot, datë 14.11.2025 *"Kërkese për dhënie mendimi të qartë e përfundimtar lidhur me mënyrën e përdorimit dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar për vitin 2025"*
- Shkresa e AKMC-së me nr.1921 prot, datë 28.10.2025 përgjigje për përdorim fondi.